



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:093797
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05772167
CAP.nr.1181/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Naim Mehulli, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike sh.a Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, me seli në Prishtinë, kundër debitorit I.R nga fsh....., P....., duke vendosur lidhur me ankesat e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë PPP.nr.39/2023, të datës 19.06.2023, me datë 03.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pathemelta ankesa e debitorit I.R nga fsh....., P....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë PPP.nr.39/2023, të datës 19.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.39/2023, të datës 19.06.2023, ka vendosur si në vijim: “**REFUZOHET si i pa bazuar** prapësimi i parashtuar i debitorit I.R nga fsh....., P..... i datës: 13.04.2023, kundër Urdhrit për përmbartim P.nr.78/23 të dt.24.03.2023.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitorit të parë për shkak të shkeljes, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të pranohet e bazuar ankesa e debitorit të parë duke e ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë ose që aktvendimi të prishet ose lënda të kthehet në rigjykim

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtuar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori kreditorit Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike sh.a Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, me seli në Prishtinë, ka parashtruar propozim për përbarim ndaj debitorit I.R nga fsh....., P....., në bazë të dokumentit përbarimor aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë C.nr.621/2021, i datës 12.04.2022, i plotfuqishëm nga data 10.05.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 10.06.2022, për shkak të kompensimit të demit në shumë prej 114.44 euro.

Përbaruesi Privat Isa Shala me seli në Prishtinë, me urdhrin P.nr.78/23, të datës 24.03.2023, e ka caktuar përbarimin duke vlerësuar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë C.nr.621/2021, i datës 12.04.2022, i plotfuqishëm nga data 10.05.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 10.06.2022 i plotëson kushtet si vendim përbarues.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit debitorit ka paraqitur prapësim më datën 13.04.2023, duke theksuar se e kundërshtoj ekzekutimin e propozuar ngase për arsye se ne këtë rast kemi të bejm me parashkrim konform nenit 360 të LMD-së.

Kreditorit në afatin e paraparë ligjor me datë 13.04.2023, ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.39/2023, të datës 19.06.2023, ka vendosur që ta refuzoj prapësimin e debitorit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar, duke theksuar se ka vlerësuar se dokumentit përbarues-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë me numër të lëndës C.nr.621/2021 të dat.12.04.2022 i plotfuqishëm nga dt.10.05.2022 e i ekzekutueshëm me dt.10.06.2022 në bazë të cilit organi përbarues ka zbatuar përbarimin, është dokument përbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit nga se i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par 1 pika 1.1 të LPP-së ku është përcaktuar se **“vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese”**, nenit 23 par.1 të LPP-së, ku është përcaktuar se **“Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”** dhe nenit 27 të LPP-së për të qenë i përbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim. Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të debitorit ka gjetur se prapësimi i debitorit i parashtruar me datën 13.04.2023, kundër Urdhrit për përbarim P.nr.78/23 të dt.24.03.2023 është i pa bazuar. Debitorit prapësimin nuk i ka bashkangjitur as një provë për të cilën ka qenë i obliguar në bazë të nenit 69 par.4 të LPP-së ku përcakton se **“Baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”**, po të ishte dorëzuar ndonjë provë siç kërkohet me nenin e lartë cituat gjykata do të kishte vendos në të kundërtën me atë se ka vendos në dispozitivin e këtij aktvendimi. Në prapësimin e debitorit nuk janë paraqitur asnjë nga shkaqet e prapësimin të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së që do të pengonin përbarimin e lejuar

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet

ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Lidhur me arsyetimin e aktvendimit, gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur me korrektësi dispozitave që përcaktojnë strukturën dhe përmbajtjen e aktvendimit, ndërsa në mënyrë specifike arsyetimi i aktvendimit në vetvete paraqet një përmbajtje koherente me rrjedhë logjike edhe për gjendjen e fakteve të konstatuara nga ana gjykatës së shkallës së parë, e po ashtu e njëjta ka dhënë arsye të qarta lidhur me kompetencën për të vendosur në këtë çështje përmbartimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përmbartues në bazë të cilit është lejuar përmbartimi është aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë C.nr.621/2021, i datës 12.04.2022, i plotfuqishëm nga data 10.05.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 10.06.2022, i cili është dokument përmbartues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: *“dokument përmbartimor është vendimi përmbartues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbartuese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të autorizuarit të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Pretendimet e debitorit për shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përmbartimore gjykata me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke ju përmbajtur parimit të rigorozitetit formal-juridik që nënkupton se gjykata do të vlerësoj shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera, pasi që këto pretendime kanë mundur të paraqiten në kohën kur është marrë dokumenti përmbartues.

Në rastin konkret, kjo Gjykatë ka për detyrë që të vlerësojë vetëm se a janë ndërmarrë veprimet nga organi përmbartues dhe Gjykata e shkallës së parë në përputhje me Ligjin për Procedurën Përmbartimore, e jo të vlerësojë ligjshmërinë e vendimit në bazë të cilit është bërë propozimi për përmbartim. Çdo dilemë në lidhje me ligjshmërinë e vendimit-aktgjykimit (përfshirë edhe parashkrimin e kërkesëpadsisë në procedurë kontestimore) në bazë të cilit është bërë propozimi për përmbartim mundet që ta adresojë në procedurë tjetër, mirëpo tani për tani në këtë çështje, kjo Gjykatë konsideron se propozimi për përmbartim është bërë në bazë të dokumentit përmbartues dhe i ka të gjitha tiparet e dokumentit të tillë, andaj nuk gjeti arsye që të mos e përkrah vendimin e Gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përmbartimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përmbartimit.

Sa i përket pretendimit të debitorit, se kemi të bëjmë me parashkrim, Gjykata në këtë procedurë përmbartimore këto pretendime i refuzoi si të pa bazuar për arsye se në këtë rast nuk mund të

vjen në konsideratë parashkrimi pasi që kemi të bëjmë me **vendim të formës së prerë** të Gjykatës, ku neni 361 i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve përcakton këtë situatë ashtu që kërkesat e vërtetuara me vendim të formës së prerë të gjykatës ose organi kompetent përshkruhen në afat prej 10 vitesh, e që në këtë rast nga koha kur vendimi është bërë i formës së prerë e deri te paraqitja e propozimit për përmbarim nuk ka kaluar afati i lartcekur.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së (i cili është në fuqi aktualisht, me numër 04 L-139), me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CAP.nr.1181/2022, me datë 03.06.2024

Gjyqtari individual
Naim Mehulli, d.v